

**VENDIM**  
**Nr. 338, datë 5.6.2024**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 167, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË  
DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 420 669 114 (katërqind e njëzet milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e katërbëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës dhe Rrogozhinë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 185 021 720 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milionë e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi, në masën 235 647 394 (dyqind e tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar."

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet bashkive Durrës dhe Rrogozhinë në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës dhe Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**